



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E BRENDSHME
SHOQËRIA “ILLYRIAN GUARD” SH.A.
DEPARTAMENTI ADMINISTRATIV
DREJTORIA JURIDIKE**



Nr. _____ Prot

Tiranë më _____._____.2024

Miratoi :

Administratori

Anduel Xhindi

PROCES VERBAL datë __.__.2024

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“Karburant”, blerje furnizim me lëndë djegëse për automjete Diesel (Gazoil) 10 p.p.m., dhe Benzine super pa plumb 95 oct., me afat të Marrëveshjes Kuadër 1 (nje) vit nga data e nënshkrimit të kontrates.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Kodi CPV: 09100000-0 Karburante.

VLERA E FONDIT LIMIT: 8,432,454 (Tetë milion e katerqind e tridhjetë e dy mijë e katerqind e pesedhjetë e kater) Leke pa TVSH

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Illyrian Guard Sha** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen me Nenin 76 "Kriteret detyruese për skualifikim" Nenin 82 "Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit" dhe Neni 83 "Sigurimi i ofertës", të Ligjit Nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik" si dhe në mbështetje të Nenit 26 "Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit" dhe nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik:

Neni 82, i Ligjit nr.162/2020 "Për prokurimin publik" 1. *Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prova paraprake në vend të disa vertetimeve të leshuara nga autoritetet publike ose pale të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik". **Neni 83, i Ligjit nr.162/2020 "Për prokurimin publik"** "Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël",*

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

1. *Sipas kriterëve të përgjithshme të pranimit/kualifikimit pika 1 e kësaj shtojce (Shtojca 8).*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

2.2. **Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

2.2.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë Vërtetim xhiroje vjetore nga Administrata Tatimore për 2(dy) vitet e fundit, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 20 % e vlerës së parashikuar të kontratës. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëqoftëse Operatorët Ekonomike arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" "Ne lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetit ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë që operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën", "Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.", si dhe bazuar në nenin 43, pika 2/c të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: c) 40 % të vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në procedurat e prokurimit "Shërbim konsulence". Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori

ekonomik fitues i zoteron te gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare per te permbushur me sukses kontraten.

Duke marre ne konsiderate numrin e operatoreve ekonomik qe ofrojnë këto lloj furnizimesh ne tregun shqiptar, sasinë dhe cilësinë e mallit objekt procedure prokurimi, kërkohet qe OE ofertues te paraqesë dokumenta se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për ta realizuar atë ne kohe dhe ne përputhje me specifikimet teknike te kërkuara.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë në zbatim të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”, si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

Autoriteti Kontraktor në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore”: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të ketij ligji.

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të bilanceve, të certifikuara nga autoritetet përkatëse (Dega e Tatim Taksave) për vitet 2021,2022 dhe 2023 ku te paktën në nga bilancet të, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të ketij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të ketij ligji.

(Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen rastet kur personat juridikë kanë detyrimin që të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese).

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë dy viteve të fundit nga data e publikimit te njoftimit te kontrates, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 "Kërkesat për kualifikim", të Ligjit Nr 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" pika 4. "ne lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerezore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në vecanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontrata e zbatuara në të shkuarën" dhe nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë dy viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Autoriteti Kontraktor ka sigurinë dhe besueshmerinë që Operatori Ekonomik ofertues mund të realizojë kontratën objekt prokurimi pa patur pengesa të ndryshme që do të ndikonin në ecurinë e punës së Autoriteti Kontraktor.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.

Përvoja e mëparshme është një element shumë i domosdoshëm që garanton autoritetin kontraktor se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së kontratave të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Vlera e kërkuar nuk sjell kufizim të konkurrencës dhe është në masën 20% të fondit limit

2.3.2 Subjekti ofertues duhet të ketë të pakten 1 (një) Stacion (pikë karburanti) të tregtimit me pakice në Bashkitë dhe Njesitë Administrative poshteshenuar, vërtetuar me një nga

format e disponimit sipas Kodit Civil (kontrate noteriale qeraje, akt pronesia ose te jene te pasqyruara ne ekstratin tregtar te OE pjesmarres). Operatori Ekonomik duhet te paraqese Listen e detajuar te stacioneve te shitjes se karburanteve me pakice, detajuar sipas Tabeles1 te meposhtme.

Stacionet e tregtimit me pakice te karburanteve detyrimisht duhen te jene te pajisur me dokumentacion si me poshte:

- Licence leshuar nga pushteti vendor per tregtim karburantesh me pakice;
- Leje mjedisore perkatese leshuar nga QKL;
- Vertetim teknik leshuar nga Organet e Miratuara të Vlerësimit të Konformitetit (OMVK);
- Certificate e mbrotjes nga zjarri nga M.Z.SH;
- Police sigurimi ne nje nga shoqerite e sigurimeve qe operojne ne Shqiperi, per distributoret e shitje me pakice, te cilat duhet te jene brenda afatit te vlefshmerise daten e hapjes se ofertave;

Tabela 1

Nr Bashkia/Njesia Administrative	Vendodhja (adresa)	Person kontakti (Telefon)
1	Tiranë	
2	Vlorë	
3	Kukës	
4	Pogradec	
5	Elbasan	
6	Durres	
7	Tropoje	
8	Shkoder	
9	Diber	
10	Bashkia Vau Dejes	
11	Fier	
12	Lushnje	
13	Lezhe	
14	Sarande	
15	Gjirokaster	
16	Kruje	
17	Korçe	
18	Berat	

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77/4, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nënnt 40/ 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Ky kriter është vendosur nga ana e AK qe OE i ploteson kerkesat minimale te percaktuara ne DT ,te cilat vertetojne pajtueshmerine e mallit te kerkuar me specifikimet teknike.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet te paraqese një vertetim të lëshuar nga ISHTI, që vërteton se subjekti ofertues ka tregtuar karburante sipas standarteve të legjislacionit Shqiptar dhe nuk ka patur penalitete për vitin e fundit nga data e zhvillimit të procedurës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77/4, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 40/ 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Ky kriter është vendosur nga ana e AK që OE i plotëson kërkesat minimale të përcaktuara në DT, të cilat vërtetojnë pajtueshmërinë e mallit të kërkuar me specifikimet teknike.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetim për stacionet e tregtimit me pakice të karburanteve duhen të jenë të pajisur me Leje mjedisore të tipit B leshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit, Vërtetim teknik leshuar nga ISHTI ose Organet e Miratimit të Vlerësimit të Konformitetit (OMVK), Certifikate e mbrotjes nga zjarri leshuar nga M.Z.SH dhe Police sigurimi në një nga shoqëritë e sigurimeve që operojnë në Shqipëri, për stacionet e tregtimit me pakice, të cilat duhet të jenë brenda afatit të vlefshmerisë të datës së hapjes së ofertave.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 40, pika 5, gërma a,) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Ky kriter është vendosur nga ana e AK në zbatim të kërkesave që përcakton Ligji nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregëtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar, VKM nr. 147, datë 21.03.2007 “Për cilësinë e lëndëve djegëse benzine dhe diesel”, VKM nr. 970, datë 02.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe kushteve për dhënie të licencave për tregëtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” i ndryshuar, ligjin nr. 10 433, datë 16.6.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, Vendimit nr. 429, datë 26.6.2019 për cilësinë e disa lëndëve të djegshme, të lëngëta, për përdorim termik, civil e industrial, si dhe përdorim në mjetet e transportit ujor (detar, lumor dhe liqenor)”, Urdhër Nr. 6, datë 09.01.2015 “Për kontrollin e standardeve teknike të naftës dhe nënprodukteve të saj, procedurat dhe tarifatat përkatëse, Urdhërit nr 315, datë 24.08.2017 “Për procedurat e lëshimit të vërtetimit teknik për subjektet që kryejnë aktivitet në fushën e përpunimit, transportimit dhe tregëtimin të naftës dhe nënprodukteve të saj”, Ligji Nr. 52/2020 Për disa ndryshime në ligjin nr. 10 448, datë 14.7.2011, “për lejet e Mjedisit”, të ndryshuar
Vendosja e këtij kriteri nga ana e AK është bërë duke patur parasysh numrin e automjeteve të cilat duhet të furnizohen me karburant gjatë zbatimit të kontratës si dhe itineraret ditore që ato kryejnë në funksion të zbatimit të detyrave funksionale që ato kanë.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratat si më poshtë:

- Operatori ekonomik duhet të deklarojë se merr përsipër furnizimin me pika shitje karburanti me shërbim 24 orë sipas standardeve në fuqi, në qytetet ku ka vendndodhjen autoriteti kontraktor me kartë elektronike të personalizuar me targën e çdo automjeti të autoritetit kontraktor sipas kërkesave të autoritetit kontraktor.
- Operatori ekonomik duhet të deklarojë se merr përsipër furnizimin me karburant .
- Operatori ekonomik duhet të deklarojë se merr përsipër që të konvertojë të gjithë sasinë e litrave të ndodhura në kartën elektronike të personalizuar me targën e mjetit në lëng me botë deri në përfundimin e plotë të kontratës, sipas nevojave të autoriteteve kontraktore. Karta elektronike duhet të jenë pa skadencë deri në përfundimin e plotë të sasisë të përcaktuar.
- Operatori ekonomik duhet të mbulojë furnizimin nëpërmjet karteve elektronike të personalizuar, sipas adresave të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor.

Bazuar në VKM nr. 561, datë 29.07.2016, “Për Standartizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve të karburantit në njesitë e qeverisjes së përgjithshme” Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet

të ofrojnë një faqe menaxhimi të karburanteve (webpage), ku furnizimi dhe shpenzimi i karburantit për mjetet efektive të transportit të kryhet nëpërmjet kartës elektronike.

- Faqja e menaxhimit të karburanteve (webpage) duhet të ofrojë shërbimin e ngarkimit të sasisë së karburantit nga Operatori ekonomik drejt Autoritetit Kontraktor, me qëllim që rimbushja e kartave elektronike të personalizuar me targën e mjetit si dhe administrimi i sasisë së karburanteve të kryhet nga vet Autoriteti kontraktor.
- Faqja e menaxhimit të karburanteve duhet të ofrojë edhe shërbimin për krijimin e strukturës piramidale në përputhje me strukturën piramidale të Autoritetit kontraktor, shërbimin e furnizimit me karburant nëpërmjet kartave elektronike stikera (pulla), të cilat ngjiten në xhamin e automjetit dhe ofrojnë shërbimin e furnizimit me karburant vetëm për atë automjet për të eliminuar lëvizjen e mundshme të targave nga mjetet shtetëror drejt mjeteve private, si dhe shërbimin e dërgimit të fotografive me anë të e-mailit për çdo furnizim të kryer të mjetit pranë stacionit të shitjes së karburanteve me pakicë me qëllim identifikimin e mjetit dhe përdoruesit të saj.
- Disponimi /Ekzistenca e faqes së menaxhimit të karburanteve (webpage), së bashku me ofrimin shërbimeve të kërkuara mësipër, do të demonstron nga ana e operatorëve ekonomik pjesëmarrës nëpërmjet manualit të përdorimit me shembuj për zbatimin në praktikë.
- Mos ofrimi i shërbimeve të kërkuara mësipër në mënyrë elektronike nëpërmjet Faqes së menaxhimit të karburanteve (webpage), që ofron çdo operator ekonomik pjesëmarrës përbën kusht për skualifikim.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika , gërma ç,) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Eshte kerkuar qe operatori ekonomik te vetdeklaroje deklarimet e mesiperme pasi AK kerkon garanci qe furnizimi do te realizohet me karta elektronike sipas VKM Nr 561 date 29.07.2016“Per Standartizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve te karburantit ne njesite e qeverisjes se pergjithshem“, Kartat do kene vlefshmeri deri ne mbarimin e plote te sasise se Karburantit të prokuruar furnizimi me karburant do behet per ne pistolete publike dhe sherbim 24 ore etj.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Benzinë e standartit 228: 2012 + A1 :2017

2.Specifikimet teknike dhe argumentimi të benzine pa plumb 95 oct, sipas Standartit SSH EN 228:2012+ A1:2017

Të dhënat teknike dhe argumentimi të Benzine pa plumb 95 oct i referohen standardit evropian (EN) të adoptuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit dhe që ka statusin e standardit shqiptar (S SH): Lëndë djegëse për automjete - Benzine pa plumb 95 oct sipas **sipas standartit SSH EN 228:2012+ A1:2017**

Kërkesa të përgjithshme të zbatueshme dhe metodat e provave

Tipari	Njësia	Limitet		Metoda e testimit a
		Min	Max	
Numri oktanit në kërkim, RON		95.0	-	SSH EN ISO 5164 b ASTM D 2699
Numri oktan i motorit, MON		85,0	-	SSH EN ISO 5163 ASTM 2699
Densiteti në 15 ⁰ C	kg/m ³	720.0	775,0	EN ISO 3675 EN ISO 12185 ASTM D 7777 ASTM D 4052
Përmbajtje squfuri	Mg/kg	-----	10.0	EN ISO 13032 EN ISO 20846 EN ISO 20884
Presioni i avullit (VP)	kpa	45,0	100,0	SSH EN ISO 13016-1
Korrozioni i shiritit të Bakrit (3 ore ne 50 grade	vlerësim	klasi 1		EN ISO 2160
Paraqitja		e qartë dhe e ndritshme		inspektimi vizual
Përmbajtja e tipit hidrokarbur Ofelinat Aromatiket	% (V/V)	----- -----	18,0 35	EN 15553 EN ISO 22854
Përmbajtja e benzenit	% (V/V)	-----	1,00	SSH EN 238 ASTM D 6277
Përmbajtja e oksigjenit	%(m / m)		2,7	EN 1601 EN 13132 EN ISO 22854

Permbajtja e komponimeve oksigjenore				
Metanol (alkol metilik) f	% (v/v)		3,0	
Etanol (alkol etilik) g			5,0	
-alkool izopropil -izo-butil alkool - alkool tert-butil -eteret (5 ose më shumë atome C) -oksigjenate të tjera			Përzierja e volumit është kufizuar në maksimum 2,7% (m/m). përmbajtjen e oksigjenit	SSH EN ISO 15553:2007 ASTM 5845-01
Distilimi				
a- Distilon deri 70°C	% (v/v)	20	48	SSH EN ISO 3405 ASTM D 86
b- Distilion deri 100°C	% (v/v)	46,0	71,0	
c- Distilion deri 150°C	% (v/v)	75	--	
d- Pika finale distilimit	°C	---	210	
e- Mbetjet e distilimit	% (v/v)	---	2	

Karburanti Gazoil 10 sipas standartit SSH EN 590 : 2022

1.Specifikimet teknike dhe argumentimi të Naftë (Gazoil-10ppm), sipas Standartit SSH EN 590:2022.

Të dhënat teknike dhe argumentimi të Gazoil 10 PPM i referohen standartit evropian (EN) të adoptuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit dhe që ka statusin e standartit shqiptar (SSH): Lëndë djegëse për automjete – Naftë (Gazoil) sipas S SH EN 590:2022

Kërkesa të përgjithshme të zbatueshme dhe metodat e provave

Tipari	Njësia	Limitet		Metoda e testimit a (Shiko paragrafin 2 Rekomandimet e detyrueshme)
		min	Max	
Numër Cetane b		51,0	-	EN ISO 5165:2020 b EN 15195:2014 EN 16715:2015 EN 16906:2017 c EN 17155:2018
Cetane index		46,0	-	EN ISO 4264
Densiteti ne 15 °C	Kg/m ³	820,0	845,0	EN ISO 3675 EN ISO 12185
Hidrokarburet aromatike polikike d	% (m/m)	-	8,0	EN 12916:2019
Përmbajtja e squfurit	mg/kg	-	10,0	EN ISO 20846:2019 e EN ISO 20884:2019 EN ISO 13032:2012
Pikë e flakerimit	°C	Mbi 55,0	-	EN ISO 2719
Mbetja e karbonit g (në 10% mbetje te distilimit)	% (m/m)		0,30	EN ISO 10370:2014
Përmbajtja e hirit	% (m/m)	-	0,010	EN ISO 6245
Pika e bllokimit te filtrit ne te ftohte CFPP	°C			SSH EN 116:2015
Përmbajtja e ujit	% (m/m)	-	0,020	EN ISO 12937
Ndotja totale(pergjitheshme)	mg/kg	-	24	EN 12662
Gërryerja e shiritit të bakrit (3 orë në 50 °C).	Vlerësimi	Klasi 1		EN ISO 2160
Përmbajtja e esterit metalik me acidit yndyror (FAME) h	% (V/V)	-	7,0	EN 14078:2014
Stabiliteti i oksidimit i	g/m ³	-----	25	EN ISO 12205 EN 15751

Lubrifikimi, diametri i veshjes se mprehte (wsd 1,4) në 60°C	µm (micrometer)	-	460	EN ISO 12156-1
Viskoziteti at 40 °C	mm ² /s	2,000	4,500	EN ISO 3104
Distilimi m.n % (V/V) rafinimi në 250 °C	% (V/V)		<65	EN ISO 3405:2019 ⁿ
% (V/V) rafinimi në 350 °C	% (V/V)	85		EN ISO 3924:2019
95 % (V/V) rafinimi	°C		360	EN 17306:2019 c

Shënim: specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Hartimi i specifikime teknike të Gazoilit (Diesel 10 ppm ULSD) është bërë në përputhje me kërkesat që përcakton Ligji nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregëtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar, VKM nr. 147, datë 21.03.2007 “Për cilësinë e lëndëve djegëse benzinë dhe diesel”, VKM nr. 970, datë 02.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe kushteve për dhënien e licensave për tregëtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” si dhe sipas Standardeve Shtetërore në fuqi që ato duhet të plotësojnë. Të dhënat teknike të Gazoil D1 (Eurodizel) dhe benzinës pa plumb i referohen standardit evropian (EN) të adoptuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit dhe që ka statusin e standardit shqiptar (S SH):

Gazoil (Diesel 10 ppm ULSD), për qëllim transporti sipas standardit:

S SH EN 590:2022

Lëndë djegëse për automjete. Gasoil (Diesel 10ppm ULSD)

Benzinë pa plumb (Unleaded Petrol), për qëllim transporti sipas standardit:

S SH EN 228:2012 + A1 : 2017

Lëndë djegëse për automjete. Benzinë pa plumb (Unleaded petrol)

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

➤ Argumentimi : Sipas set-it të DT hartuar nga APP.

Këto kritere në përgjithësi ruajnë raportin e proporcionalitetit me vlerën, objektin e kontratës si dhe rendësinë e kontratës objekt prokurimi për institucionin e rendesise së vecante, për të siguruar cilësinë e mallit dhe nuk janë diskriminuese. Ato shërbejnë për të identifikuar optimalisht kapacitetet teknike dhe ekonomike të operatoreve.

Në lidhje me *kushtet e veçanta për kualifikim*, njësi e prokurimit bazuar në rregullat e prokurimit publik të referueshme , në raport me shumën dhe mallin e kërkuar përcaktoi këto kritere si minimumin e kërkuar për t'u plotësuar nga operatorët ekonomike.

Në seksionin e specifikimeve teknike, *janë marrë* nga Drejtoria e Përgjithshme e Standartizimit, fatura me nr. 141/5 datë 17.03.2023.

Argumentimi : Gjate hartimit të specifikimeve teknike , Grupi i punës për hartimin e tyre , për një kategori mallrash specifike ka kërkuar përputhshmerinë me disa standarte EN , kjo me qëllim për të harmonizuar rregullat teknike dhe ligjet brenda tregut evropian. Gjithashtu AK thekson që fjalën e përdorur “ekuivalent” është përdorur në ato zera ku ka qenë e nevojshme kërkesa e standartit EN (është përdorur në baze të rekomandimeve të APP-së për vitin 2021).

NJËSIA E PROKURIMIT